



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 7967 (31104-01670-86-2015) Rregj.Them.  
Data Regjistrimi 25.03.2015

Nr. 872 (57) Vendimi  
Datë 23.04.2015

V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

4653  
16/05/2015

Gjykata Administratiye e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA  
GJYQTARE - Altina NASUFI  
GJYQTARE - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot me datë 23.04.2015, ora 13:40 shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë :

**PADITËS:** Shoqëria "Edra-06" sh.p.k me adresë kryesore: lagja "Kongresi i Përmetit", rruga "Oso Kuka", pallati Fishta, kat 2, Shkodër.

**E PADITUR:** Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.

**OBJEKTI:** Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative "Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore" nr. 8665 Prot., dhe nr. 998/3 Prot., nxjerrë nga pala e paditur në dëm të palës paditëse dhe shfuqizimin tërësisht të tyre.

Konstatimin si akte relativisht të pavlefshme të "Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore" nr. 262 Prot., dhe nr. 262/3 Prot, dhe detyrimin e palës së paditur që t'i ndryshojë pjesërisht ato përsa i përket masës së gjobës nga 100% në një masë tjeter më të ulët, në raport të drejtë me dëmin e shkaktuar.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 31 dhe 32 të K. Pr. Civile, nenet 115/5, 116/c, 118/2, 119 të K.Pr. Administrative, nenet 7, 15, e vijues të ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr. 24, datë 19.01.2015 ka vendosur :

1. "Rrezimin e kërkësë padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë".

Kundër këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka paraqitur ankim pala paditëse në datën 02.02.2015 duke parashtruar shkaqet si më poshtë vijon:

1. *Pala e paditur ka nxjerrë njoftim vlerësimin për detyrime tatimore nr. 8665, datë 15.12.2008, i cili në fakt është njoftim vlerësimi i raportit përfundimtar të kontrollit. Shoqërisë paditëse nuk i është njoftuar një raport kontrolli paraprak në lidhje me këtë njoftim vlerësimi siç përcakton neni 83 e vijues i ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Në këto kushte shoqëria ka humbur të drejtën e ankimit pasi i ka kaluar afati i bërges së ankimit.*
2. *Pala e paditur nuk ka zbatuar procedurën e kontrollit, pasi nuk ka nxjerrë një akt kontrolli paraprak. Neni 116 gërmë "c" e K. Pr. Administrative përcakton se akti është absolutisht i pavlefshëm kur është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e përcaktuar nga ligji.*
3. *Shoqëria paditëse nuk i ka paguar detyrimet vullnetarisht siç ka argumentuar gjykata, por është detyruar të bëjë pagesën.*
4. *Në lidhje me aktin administrativ njoftim vlerësimi tatimore nr. 998/3 Prot. datë 16.02.2012, ky është një akt absolutisht i pavlefshëm pasi është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e përcaktuar nga ligji. Pala paditëse e ka njoftuar palen e paditur se për arsy familjare të administratorit të shoqërisë të kishte një shtyrje kontrolli. Pala e paditur e ka refuzuar këtë kërkesë të palës paditëse, por pa e njoftuar këtë të fundit për refuzimin. Në këto kushte shoqëria paditëse duke mos ditur refuzimin e kërkesës së saj për shtyrje kontrolli, ka vazhduar e qetë punën e saj, duke mos e llogaritur këtë kontroll.*
5. *Pala e paditur në mënyrë të papritur në kundërshtim flagrant me ligjin ka gjobitur në datën 16.03.2012 pa asnjë njoftim palen e paditur në shumën 1000.000. Ilekë për pengim kontrolli. Kjo gjobë rezulton se gjithashtu është nxjerrë në kundërshtim me procedurën ligjore.*

Sa sipër pala paditëse kërkon ndryshimin e vendimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative nr. 8665, datë 15.12.2008 dhe nr. 998/3 Prot. datë 16.03.2012 të DRT Shkodër.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

#### VËREN

Pala paditëse shoqëria "Edra-06" sh.p.k, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me kërkesë padi duke kërkuar:

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative "Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore" nr. 8665 Prot., dhe nr. 998/3 Prot., nxjerrë nga pala e paditur në dém të palës paditëse dhe shfuqizimin tërësisht të tyre. Konstatimin si akte relativisht të pavlefshme të "njoftim vlerësimi për detyrime tatimore" nr. 262 Prot., dhe nr. 262/3 Prot, dhe detyrimin e palës së paditur që t'i ndryshojë pjesërisht ato përsa i përket masës së gjobës nga 100% në një masë tjetër më të ulët, në raport të drejtë me démin e shkaktuar.

Pala paditëse në lidhje me këto kërkime i ka referuar si bazë ligjore në nenet 31 dhe 32 të K. Pr. Civile, nenet 115/5, 116/c, 118/2, 119 të K.Pr. Administrative, nenet 7, 15, e vijues të ligji

nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr. 24, datë 19.01.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së shoqërisë "Edra-06" sh.p.k. Kundër këtij vendimi ka bërë ankrim pala paditëse për shkaqet e përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala paditëse është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, e për rrjedhojë, është shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimin. Në këto rrëthana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

#### *Rrethanat e çështjes*

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 24, datë 19.01.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton se:

Shoqëria "Edra-06" sh.p.k ushtron aktivitet tregtar me objekt: "Projektim, ndërtim, ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime gërmime, rikonstrukSIONE, etj."

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër (DRT Shkodër) ka ushtruar një vizitë fiskale pranë palës paditëse duke e dokumentuar atë në proceverbalin e datës 08.08.2008 dhe duke përpiluar aktin e kontrollit të po kësaj date. Ky akt kontrolli i është njoftuar shoqërisë paditëse. Në zbatim të kontrollit të bërë pala e paditur ka nxjerrë Njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr. 8665 Prot. datë 15.12.2008 sipas të cilit Shoqëria paditëse gjobitet për mosdeklarim të TVSH-së me gjobë në masën 425.174 lekë. Në lidhje me këtë njoftim vlerësimi tatimor pala paditëse ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor, e cila pasi ka shqyrtuar ankimin e palës paditëse me vendimin nr. 1093, datë 10.04.2009 ka vendosur lënien në fuqi të Njoftim vlerësimit për detyrimet nr. 8665 Prot. datë 15.12.2008. Pala e paditur DRT Shkodër ka njoftuar palën paditëse për zhvillimin e një kontrolli pranë saj sipas programit të kontrollit nr. 998 që do të kryhej në periudhën kohore 09-17.02.2012. Pala paditëse ka bërë një kërkesë për shtyrjen e kontrollit për shkak të pamundësisë së qënies prezent të administratorit të shoqërisë. Kjo kërkesë është refuzuar nga pala e paditur inspektorët e të cilës janë paraqitur pranë ambjenteve të shoqërisë paditëse për kryerjen e kontrollit. Pala paditëse ka penguar inspektorët për të vazhduar kontrollin e programuar duke mos bashkëpunuar me ta dhe për 'pasojë pala e paditur me Njoftim Vlerësimin për detyrimet nr. 998/ Prot. datë 16.03.2012 ka gjobitur palën paditëse për pengim të kontrollit tatimor me shumën 1.000.000 lekë. Ky njoftim i është dërguar me postë shoqërisë paditëse. Në vijim DRT Shkodër ka njoftuar palën paditëse me njoftimin për kontroll nr. 262 Prot. datë 04.09.2012 se do të ushtrojë kontroll tatimor pranë saj, duke i njoftuar dhe programin e kontrollit tatimor. Në përfundim të kontrollit, DRT Shkodër i ka njoftuar palës paditëse aktin administrativ :Njoftim Vlerësimi për detyrim nr. 262/3 Prot. Datë 05.11.2012. Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar në datën 16.06.2014 Gjykates Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me kërkesë padinë me objekt, palë të paditura dhe bazë ligjore siç përshkruhet në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr. 24, datë 19.01.2015 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së shoqërisë "Edra-06" sh.p.k si të pabazuar në ligj e në prova.

Nga përbajtja e vendimit nr. 24 të datës 19.01.2015 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër rezulton se gjykata ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Kërkimi i paditësit për konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të njoftim vlerësimit tatimor nr. 8665, datë 15.12.2008 të DRT Shkodër është i paargumetuar referuar nenit 116 të K. Pr. Administrative.
2. Në rastin konkret nxjerra e aktit administrativ nr. 8665, datë 15.12.2008 nga DRT Shkodër është bërë pas kryerjes së një vizite fiskale nga pala e paditur pranë palës paditëse. Kjo formë kontrolli është e mirëpërcaktuar në ligj. Edhe sikur të mendonim se mos-hartimi i raportit paraprak të kontrollit nga pala e paditur është në shkelje të procedurave të hetimit administrative, përsëri rezultati i kontrollit është i njëjtë prandaj gjykata referuar nenit 40/4 të ligjit organik nr. 49/2012, çmon se ky pretendim i paditësit është i pabazuar.
3. Paditësi ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj këtij akti administrative pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor, e cila pasi ka shqyrtau ankimin e palës paditëse ka vodosur lënien në fuqi të aktit administrative objekt ankimi.
4. Pala paditëse ka ekzekutuar vullnetarisht detyrimin tatimor të përcaktuar me njoftim vlerësimin për detyrime nr. 8665 Prot. Datë 15.12.2008.
5. Në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit tatimor nr. 998/3 Prot. Datë 16.03.2012, gjykata çmon se është i pabazuar pasi pala paditëse është njoftuar për programin e kontrollit nr. 998 dhe autorizimin për kryerjen e kontrollit. Pala paditëse ditën e fillimit të kontrollit ka paraqitur një kërkesë për shtyrje që nuk është miratuar nga pala e paditur. Pala e paditur e ka njoftuar shoqërinë paditëse për refuzimin e kërkesës për shtyrje dhe kjo e fundit nuk ka bashkëpunuar për kryerjen e kontrollit sipas programit dhe ka refuzuar të firmosë njoftim kontrollin.
6. Për pasojë njoftim vlerësimi tatimor nr. 998/3 Prot. datë 16.03.2012 për dënimin me gjobë në shumën 1.000.000 lekë të shoqërisë paditëse për pengim kontrolli tatimor është në përputhje me nenin 127 të ligjit nr. 9920/2008.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tëresinë e rr Ethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjt të zbatueshëm në rastin konkret.

#### Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, akteve të dosjes së gjykimit, si dhe të vendimit objekt ankimi, Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr.24, datë 19.01.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjt procedural dhe të ligjt material e përrjedhojë duhet të lihet në fuqi.

Në rastin objekt gjykimi rezulton se DRT Shkodër ka ushtruar kontroll tatimor të llojit "vizitë fiskale" pranë shoqërisë paditëse në datën 08.08.2008. Në përfundim të vizitës fiskale të dokumentuar në përputhje me ligjin pala e paditur ka nxjerrë aktin administrative "Njoftim vlerësimi për detyrimet" nr. 8665 Prot. datë 15.12.2008 për detyrimin për TVSH-në e nxjerrë pas kontabilizimit të detyrimeve në shumën 32.636 lekë për periudhën tatimore Tetor 2008 dhe gjobat për TVSH-në për periudhat Shkurt-Prill 2008 në shumën 425.174 lekë. Pala paditëse pasi ka marrë këtë akt administrative të palës së paditur ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor. Kjo e fundit pasi ka shqyrtau ankimin e palës

paditëse me vendimin nr. 1093, datë 10.04.2009 ka vendosur lënien në fuqi të aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet" nr. 8665 Prot. datë 15.12.2008 të DRT Shkodër.

Në vijim DRT Shkodër ka njoftuar shoqërinë-puditëse për zhvillimin e një kontrolli pranë saj sipas programit të kontrollit nr. 998 që do të kryhej në periudhën kohore 09-17.02.2012. Pala paditëse ka bërë një kërkesë për shtyrjen e kontrollit për shkak të pamundësisë së qënies prezent të administratorit të shoqërisë. Kjo kërkesë është refuzuar nga pala e paditur inspektorët e të cilës janë paraqitur pranë ambjenteve të shoqërisë paditëse për kryerjen e kontrollit. Pala paditëse ka penguar inspektorët për të vazhduar kontrollin e programuar duke mos bashkëpunuar me ta dhe për pasojë pala e paditur me Njoftim Vlerësimin për detyrime nr. 998/ Prot. datë 16.03.2012 ka gjobitur palën paditëse për pengim të kontrollit tatimor me shumën 1.000.000 lekë. Ky njoftim i është dërguar me postë shoqërisë paditëse.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me vendimin objekt ankimi e ka rrëzuar padinë me argumentin se nuk jemi përpëra asnjë prej rasteve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ.

Ky vlerësim i gjykatës së shkallës së parë rezulton të jetë në përputhje të plotë me rrethanat e faktit të vërtetuara në gjykim si dhe me përcaktimet e ligjit.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se në rastin objekt gjyktimi aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse nuk janë absolutisht të pavlefshme sipas përcaktimeve të nenit 116 të K. Pr. Administrative.

Neni 116 i K.Pr. Administrative përcakton se:

*"Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:*

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji

Rezulton se këto akte janë nxjerrë nga pala e paditur në formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji dhe në ushtrim të kompetencave dhe autoritetit të dhënë nga ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Pala paditëse është njoftuar në lidhje me kontrollin e ushtruar pranë saj, i është komunikuar detyrimi tatimor nëpërmjet aktit administrativ nr. 8665 Prot. datë 15.12.2008, ka ushtruar të drejtën e ankimit në përputhje me ligjin, ankimi i bërë nga shoqëria paditëse në lidhje me këtë akt administrativ është shqyrtuar dhe përgjigja i është njoftuar kësaj të fundit. Pretendimi i palës paditëse i paraqitur në ankimin e saj përpëra Gjykatës se aktet e palës së paditur janë në kundërshtim flagrant me ligjin është një pretendim i pabazuar në ligj e në prova. Rezulton se masa administrative e marrë nga pala e paditur ndaj palës paditëse është bazuar në shkeljen e ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH", konkretisht neni 128 i tij "Lëshimi i faturës së pasaktë".

Gjykata Administrative e Apelit çmon se, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se akti administrativ i kundërshtuar nga pala paditëse njoftim vlerësimi tatimor nr. 998/ Prot. datë 16.03.2012 nuk përbën një akt administrativ absolutisht të paligjshëm në kuptim të nenit 116 të K.Pr. Administrative të sipërcituar.

Gjykata çmon se ky akt është nxjerrë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920/2008 që gjen zbatim në rastin objekt gjykimi e konkretisht në nenin 127 të tij i cili përcakton se:

*"Tatimpaguesi, i cili, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë, pengon ushtrimin e të drejtave të administratës tatimore për kontrollin apo hetimin tatimor, dënohet me një gjobë nga 100 000 lekë, për biznesin e vogël dhe 1 000 000 lekë për bizneset e tjera.*  
*2. Të drejtën për miratimin e masës së gjobës, të parashikuar në pikën 1 të këtij nenit, e ka drejtori i drejtorisë rajonale apo titullari i njësisë së ngashme me të. Për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël, kjo e drejtë i takon titullarit të zyrës së tatim-taksave të qeverisjes vendore".*

Gjykata çmon se në rastin konkret pala paditëse ka penguar inspektorët e palës së paditur në ushtrimin e kontrollit të njofuar më parë palës paditëse. Fakti që pala paditëse ka paraqitur një kërkesë për shtyrje kontrolli që është refuzuar nga pala e paditur, nuk përbën shkak ligjor për mosbashkëpunim me autoritet tatimore, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9920/2008. Për sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vlerësuar drejt faktin se aktet administrative objekt gjykimi nuk janë absolutisht të pavlefshme.

Në analizë të sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se pretendimet e ngritura në ankım nga pala paditëse janë të pabazuara në rrëthanat e faktit si dhe në përcaktimet e ligjit e si të tilla këto pretendime janë të papranueshme.

Në rrëthanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërmë "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykin e mosmarrëveshjeve administrative", çmon se vendimi nr. 24, datë 19.01.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është një vendim i bazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërmë "b" të ligjit Nr. 49/2012  
*"Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykin e mosmarrëveshjeve administrative",*

#### VENDOSI

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 24, datë 19.01.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
2. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.  
U shpall në Tiranë sot më datë 23.04.2015

GJYQTARE  
Rilinda SELIMI  
d.v

GJYQTARE  
Altina NASUFI  
d.v

GJYQTAR  
Kastriot SELITA  
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari  
Leonard Steaty  
Brooks